



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:


Mr/Ms. B.

18/01/2024

04/55



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo - Republic of Kosova
KOMUNA MALISHEVË



DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCË DHE BUXHET

Plani i punës për vitin 2024

Drejtori: Blerim Thaçi

Dhjetor, 2023

Përmbajtja

Hyrje.....

Objektivat

Analiza

Monitorimi dhe raportimi.....

Te tjera.....

HYRJE

Duke u bazuar ne Ligjin nr.08/L-066 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës, dhe Udhëzimeve Administrative që specifikojnë rregullat e aplikimit të Ligjit. Qëllimi i legjislacionit të larte shënuar është përcaktimi i Buxhetit të Republikës së Kosovës ndarja e buxhetit të organizatave buxhetore. Për te siguruar një pune efikase Drejtoria për Ekonomi, Financë dhe Buxhet përgatit Planin e Punës për vitin 2024, në të cilin plan do të paraqiten objektivat dhe dinamika e arritjes se këtyre objektivave për këtë vit. Qëllimi i këtij plani është te përgatisim një plan menaxhimi të bazuar në kapacitete subjektive dhe teknike që janë në drejtorinë tonë te bazuar në performancën e deritashme dhe shfrytëzimit sa më te mirë të kapaciteteve që i ka kjo drejtori si dhe mundësit e përmirësimit të performancës dhe kushteve të punës si domosdoshmëri e rritjes së rezultateve të punës. Zbatimi i përvojës që është krijuar nga stafi i drejtorisë, dhe mundësia e përmirësimit të shërbimit për drejtorinë dhe raportimet sa më të sakta.

Realizimi i objektivave për vitin 2024

Për vitin 2023 janë realizuar objektivat e punës në përgjithësi me sukses. Ekzekutimi i buxhetit të këtij viti deri në muajin dhjetor është ekzekutuar në nivel maksimal sipas planifikimit, shtu ketu tejkalimin e shpezimit të buxhetit I realizuar nga të hyrat vetanake që kemi arritur mbi 160%, që është shkallë e lartë e ekzekutimit. Alokimi i të hyrave në afate kohore të përcaktuara me kohë, zotimi i buxhetit, procedimi i gjitha shpenzimeve për Komunën e Malisheves, si dhe raportimet në baza kohore për gjitha proceset e lartcekura. Pa dyshim që si pikë e rëndësishme e drejtorisë tonë është edhe planifikimi i buxhetit për të gjitha kategoritë ekonomike si dhe futja e të dhënave buxhetore në sistemet PIP dhe BDMS për të gjitha drejtoritë e Komunës. Menaxhimi i bazuar në performancë është një qasje që në mënyrë sistematike mundëson përmirësimin e performancës përmes një procesi të vazhdueshëm të vendosjes së objektivave, matjes së performancës përmes grumbullimit, analizimit dhe rishikimit të të dhënave. Dhe kështu duke i shfrytëzuar këto të dhëna vijmë edhe të rritja e performancës. Rëndësia e menaxhimit duhet të bazohet në performancë e jo në numër të aktiviteteve, sepse rezultatet janë ato që flasin. Duke u bazuar në rezultatet e arritura për vitin 2023 na mundësojnë një komoditet për vazhdimin e suksesit edhe për vitin 2024. Njëkohësisht na mundësohet edhe në hapat e mëtejshëm se si të vazhdohet me suksese në vazhdim. Dinamika e punës sipas këtij plani duhet të përcillet çdo javë me qëllim të mos ketë ngecje në përmbushje, por në mënyrë sistematike të përcillen të arriturat të përcaktuara në këtë plan.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

- Hartimi i Propozimit Buxhetit të Komunës përmes një sistemi transparent, në pajtim me praktikën më të avancuar si dhe me Qarkoret buxhetore të nxjerr nga Ministria e Financave, i cili është kry me kohë,
- Ngritjen e përgjegjësi dhe kontrollit për realizimin e financave publike;
- Krijimi i një softuerit më të avancuar për kontabilitet, personel, paga e mëditje, e të tjera bazuar në standarde për t'iu qasur punës më shpejt dhe më me efikasitet dhe trajnimi dhe aftësimi i stafit;
- Krijimi, sigurimi i një data baze me adekuate për të hyra;
- Realizimi i buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet) përmes kontrollit të raporteve periodike që do të bëhen në Kuvendin Komunal dhe në Ministri të Financave.
- Bashkëpunimi kolegjial me stafin e drejtorive të tjera për vlerësimin sa më profesional të projekteve kapitale, si dhe rreth barazimit të të hyrave të komunës së Malisheves. Për të arritur objektivat kërkohet mobilizim i të gjithë kapaciteteve që ka drejtoria jonë duke u angazhuar në

punën e përditshme sipas këtij plani dhe duke kërkuar raportime te përditshme për punën e kryer te se cilit punëtor brenda drejtorisë.

Plani drejtorisë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet sipas muajve

Muaji Janar

- Përgatitja e planit të rrjedhjes së parasë për vitin aktual
- Vendosija ne BDMS e ndarjeve buxhetore për vitin 2024
- Raportimin mujor për komunën e Malisheves për të hyra dhe të dalura
- Raportin e Obligimeve të bartura nga viti i kaluar në vitin aktual në MF-Thesari
- Përgatitja e Raporti Vjetor Financiar për Bord, Komitet dhe Kuvend për periudhën Janar – Dhjetor
- Përgatitje e raporteve, regjistrimin e THV duke i klasifikuar në kode ekonomike
- Reaportet ditore të të THV
- Përgatitje e ekipeve të tatimit në pronë
- Raporti periodik i monitorimit të projekteve në sistemin PIP
- Azhurnimi i të dhënave lidhur me pasuritë kapitale dhe të palujtshme në sistemin SIMFK dhe jokapitale
- Zotimi, shpenzimi dhe Certifikimi i lëndëve
- Studimi i rregullorës së re për ngarkesa, tarifa dhe gjoba

Muaji Shkurt

- Pergatitja e pasqyrave financiare për vitin e kaluar Janar - Dhjetor.
- Auditimet nga ana e ZAP për vitin e kaluar
- Raportimin javor për sektor të buxhetit dhe financave
- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet
- Raportimin mujor për komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 01/2024
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Pasqyra e mjeteve të bartura nga viti paraprak
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve
- Zotimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Mars

- Raportimin javor për sektor të buxhetit dhe financave
- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet
- Raportimin mujor për komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 02/2024
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Shperndarja e aktvendimeve mbi caktimin e taksave komunale vjetore
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve
- Zotimi, shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

• Ne fund të tre mujorit zyrtari i të hyrave mbyll gjendjen e të hyrave të grumbulluara dhe pregatit kërkesën për transferin e mjeteve nga MF-Thesari

Muaji Prill

• Raporti tremujorit të parë 2024 të performancës së Investimeve kapitale te Kryetari i Komunës dhe MF

• Përgatitja e Raportit Financiar për Bord, Komitet dhe Kuvend për periudhën Janar – Mars (TM-1)

- Barazimi tremujorit të parë (TM-1) për të hyra dhe të dalura me MF- Thesar
- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet
- Raportimin mujor për komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 03/2024
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve
- Zotimi, shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Maj

- Plani i veprimit për procesin e buxhetit të planit afatmesëm buxhetor.
- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet
- Raportimin mujor për komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për tremujorin e fundit barazim me Thesar
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 04/2024

- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve
- Zotim shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Qershor

- Qarkorja Buxhetore 01/2024 – njoftimi i Drejtorive dhe Kryetarit
- Qarkorja e brendshme Interne Buxhetore 01/2024 – Z.K.F.
- Përcaktimi i orarit për dëgjimet buxhetore me qytetarë 2025-2027.
- Korniza Afatmesme Buxhetore – Komunale 2025-2027
- Informata mbi raportin e Auditimit të Jashtëm për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2023
- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet
- Raportimin mujor për komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për tremujorin e fundit barazim me Thesar
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 05/2023
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve
- Zotimi, shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Korrik

- Mbajtja e Dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për buxhetin e vitit të ardhshëm për projekte kapitale

- Qarkorja Buxhetore 02/2025 – njoftimi dhe shpërndarja

- Qarkorja Interne Buxhetore 02/2025 – njoftimi me rrjedhat interne

- Raporti tremujorit të dytë 2024 të performancës së Investimeve kapitale të Kryetari i Komunës dhe MF

- Përgatitja e Raportit Financiar për Bord, Komitet dhe Kuvend për periudhën Janar – Qershor (TM-2)

- Barazimi tremujorit të dytë (TM-2) për të hyra dhe të dalura me MF- Thesari

- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet

- Raportimin mujor për Komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura

- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.

- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për tremujorin e fundit barazim me Thesar

- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 06/2024

- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK

- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë

- Evidentimi i shpenzimeve

- Alokimi i mjeteve

- Zotimi, shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Gusht

- Përgatitja buxhetit për KPF dhe rekomandimin për asamble komunale .
- Raporti i dëgjimeve Buxhetore me publikun.
- Përcaktimi i Orarit për takimet e veçanta me secilin Drejtor të drejtorive për finalizim të buxhetit
- Dorëzimi i Draft- Buxhetit 2025-2027 Kryetarit për Aprovim për Komitet dhe Kuvend Komunal.
- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet
- Raportimin mujor për komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për tremujorin e fundit barazim me Thesar
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 07/2024
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve
- Zotimi, shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Shtator

- Shqyrtimi i Draft Buxhetit 2025 -2027 në Komitet dhe aprovimi në Kuvend (deri më 30.09.2024)
- Dorëzimi në MF propozim buxhetin dhe KAB për vitin vijues
- Regjistrimi i buxhetit në Sistemin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit – BDMS
- Regjistrimi i buxhetit Programin për Investime Publike – PIP
- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet

- Raportimin mujor për komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për tremujorin e fundit barazim me Thesar
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 08/2024
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë
- Alokimi i mjeteve
- Zotimi, shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Tetor

- Njoftimi me afatet e regjistrimeve të zotimeve si dhe procedurat e realizimit të buxhetit në fund të vitit (mbyllja e avancit, petty-cesh, paradhëniet, pagat etj.)
- Raporti tremujorit të tretë të performancës së Investimeve kapitale Kryetarit të Komunës dhe MF
- Përgatitja e Raportit Financiar për Bord, Komitet dhe Kuvend për periudhën Janar – shtator (TM-3)
- Barazimi tremujorit të tretë (TM-3) për të hyra dhe të dalura me MF- Thesari
- Raportimin mujor për Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për tremujorin e fundit barazim me Thesar
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 09/2024
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve

- Zotimi, shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Nëntor

- Auditimet nga ana e ZAP për vitin aktual
- Raportimin mujor për komunën e Malisheves për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për tremujorin e fundit barazim me Thesar
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 10/2024
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve
- Zotimi, Shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara

Muaji Dhjetor

- Mbyllja e librit të përgjithshëm të thesarit për vitin aktual.
- Raportimin mujor për Komunën e Malishevës për të hyra dhe të dalura
- Përcjellja e pagesave dhe respektimi i orarit të pagesave.
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për tremujorin e fundit barazim me Thesar
- Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha drejtoritë për muajin 11/2024
- Regjistrimi i pasurisë në SIMFK
- Evidentimi i faturave ditore nga të gjitha drejtoritë
- Evidentimi i shpenzimeve
- Alokimi i mjeteve

- Zotimi, Shpenzimi dhe aprovimi i lëndëve të shpenzuara
- Mbyllja e arkës

Për realizimin e objektivave është e domosdoshme një bashkëpunim më i mirë dhe më i saktë me drejtoritë tjera.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE

Përparësitë

Përparësitë që mundësojnë realizimin e këtij plani është edhe gatishmëria politike, që nënkupton mbështetjen e Kryetarit në plotësimin e kushteve të punës për stafin i cili do të bëjë implementimin e këtij plani. Kushtet e punës ndikojnë direkt në realizimin e objektivave si janë: sigurimi i një softuer adekuat për futjen e të dhënave të pranuar dhe të shpenzuara (program të kontabilitetit) që do të na lehtësonte punën shumë dhe do të na ndihmonte në raportime sa me të sakta në ngritjen e përgjegjësisë dhe kontrollit për realizimin e financave publike etj.

Vështirësitë

Gjatë kryerjes së aktiviteteve të punës paraqiten vështirësi të cilat mund të vijn nga mosgatishmëria në plotësimin e kushteve të punës për stafin, të cilat ndikojnë direkt në performancë. Mungesa e përkrahjes së stafit në vendimmarrje dhe ngritjen e përgjegjësisë të stafit të drejtorive tjera bashkëpunim më i ngushtë në raportim, informim dhe vendimmarrje na shkakton vonesa në raportime në përpilime të buxhetit për vitet e ardhshme. Mungesa e pajisjeve të IT-së. Gjithashtu lendet gjygsore me permbarim për shujtat e mesimdhënësve shkaktojnë vështirësi në realizimin e projekteve sipas planifikimit buxhetor.

Mundësitë

Mundësia e realizimit të ndonjë donacioni nga organizatat e ndryshme që mbështesin punën e komunave me projekte konkrete të cilat duhet të arsyetohen në mënyre profesionale. Gatishmëria e këtyre institucioneve në mbështetje të drejtpërdrejt në organizimin e seminareve që mundësojnë krijimin e përvojave për raportime të ndryshme dhe propozime buxhetore.

Rreziqet

Rreziqet që mund të paraqiten në vitin 2024 dhe do të ndikojnë direkt në performancë janë:

- Mos planifikimi i sakt i shpenzimeve nga drejtoritë rrezikojnë në suficit.

- Lendet gjygsore me permbarim pwr shujtat e mesimdhenesve shkaktajnw veshtiresi nw realizimine projekteve sipas planifikimit buxhetor.
- Buxheti jo I mjaftueshem per realizimin e projekteve kapitale sipas kerkesave dhe nevojave.

AKTIVITETET

1. Aktiviteti: Planifikimi i buxhetit për vitin 2025-2027 sipas Qarkores Buxhetore 2025 të lëshuar nga MF

Marrja e të dhënave, analizimi, përcjellja e linjave buxhetore, përcjellja e tavaneve buxhetore, ndarja e aktiviteteve sipas kategorive ekonomike, shumat e lejuara, vlerësimet e duhura për regjistrimin e buxhetit në PIP dhe BDMS.

2. Aktiviteti: Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Auditimi i PVF 2023.

Zbatimi i veprimeve konkrete që ndërlidhen me Drejtorinë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet nga plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Auditimi i PVF 2023 si dhe monitorimi i zbatimit të këtij plani të veprimit nga drejtoritë dhe njësitë tjera.

3. Aktiviteti: Fushat informuese. (DËGJIME PUBLIKE) për kërkesat e qytetarëve sa i përket buxhetit për vitin 2025-2027 fillojnë nga 01 qershori deri 31 korrik.

4. Aktiviteti: Qasja në dokumente zyrtare nga ana e Auditorëve të Jashtëm.

• Aktivitete te tjera

Aktivitet të tjera të vazhdueshme të punës së përditshme të stafit që dalin dhe janë në kontinuitet të vazhdueshëm.

MONITORIMET DHE RAPORTIMET

- Kryetari i Komunës: Mbështetje në realizimin e objektivave. Kryetari i Komunës duke shfrytëzuar kompetencat mbështet drejtorin duke i mundësuar drejtorisë që të ketë në dispozicion

kushte të mjaftueshme dhe të nevojshme dhe ti mbështet iniciativat që mendon që janë të qëlluara dhe ndikojnë direkt në përmbushjen e objektivave. që ti beje thirrje qytetareve në mënyrë publike për pagesën e tatimit në pronë.

- Drejtori i Financave: Mbështetje për realizimin e objektivave, ndihmon në plotësimin e kushteve të punës, kërkon performancë të mirë në realizimin e objektivave.

Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financë dhe Buxhet është katalizatori që do të ndihmojë për realizimin e objektivave dhe do të plotësojë kërkesat e stafit menaxherial duke ndihmuar në plotësimin e kushteve teknike të domosdoshme siq është siguri i trajnimit të stafit, siguri me mjeteve të punës që shërbejnë për punë si pajisje të IT-së etj. Drejtori përcjell dinamikën e punës duke pranuar raportet e punës, dhe pasqyrat financiare, të arriturat në grumbullimin e të hyrave vetanake, dinamikën e të hyrave nga të gjitha Drejtoritë, Përmbushjen e obligimeve sipas dinamikës së këtij plani.

Me respekt!